 FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

RANITIDINE

TABLETA TË VESHURA ME FILM 150 mg (Ranitidine Klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Ranitidine dhe përse përdoret
- Përpara se të merrni Ranitidine
- Si ta merrni Ranitidine
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Ranitidine
- Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË RANITIDINE DHE PËRSE PËRDORET

Ranitidite përmban lëndën vepruese ranitidinë klorhidrat. Ranitidine është një antagonist i receptorëve histaminikë H₂. Në sajë të lidhjes specifike me receptorët H₂, ranitidina frenon veprimin e histaminës kështu që frenon sekretimin e acidit gastrik gjatë ditës si edhe gjatë natës. Ranitidine ul aciditetin dhe vëllimin e lëngut gastrik. Pas administrimit oral, ajo përthithet shumë shpejt dhe arrin përqëndrimin më të lartë në serum pas 2 ose 3 orësh. Ranitidina metabolizohet në mëlçi dhe jashtëqitet kryesisht me urinë. Një dozë e vetme është e efektshme për më shumë se 12 orë. Pirja e duhanit ndikon në uljen e efektit të terapisë me ranitidinë.

Ranitidine indikohet:

- në trajtimin e ulçerës duodenale;
- në trajtimin ulçerës gastrike duke përfshirë parandalimin e ulçerës duodenale të lidhur me agjentët antiinflamatorë josteroidë;
- në sëmundjen e refluksit gastro-ezofageal;
- në sindromin Zollinger-Ellison;
- si paramjekim për të ulur vëllimin dhe përmbajtjen e acidit të sekretimit gastrik, në mënyrë që të zvogëlohen pasojat e sindromit të aspirimit të acidit klorhidrik gjatë anestezisë.

2. PËRPARA SE TË MERRNI RANITIDINE

Mos merrni Ranitidine në qoftë se:

- keni mbindjeshmëri ndaj ranitidinës klorhidrat apo ndonjërit prej përbërësve të tjerë të tabletës;
- vuani nga porfiri akute. Ranitidina nuk duhet të përdoret pa këshillën e mjekut në fëmijët nën 12 vjeç.

Tregoni kujdes të veçantë me Ranitidine

- Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Ranitidine:
- ky bar mund të maskojë simptomat që shoqërojnë kancerin e stomakut kështu që duhet përjashtuar ekzistenca e kancerit malinj para fillimit të mjekimit me Ranitidine. Ranitidine duhet të përdoret me kujdes:
 - tek të moshuarit;
 - në pacientët me sëmundje të mëlçisë sepse ranitidina metabolizohet nga mëlçia;
 - tek të sëmurët me dëmtim të funksionit renal ose insuficiencë renale. Në të sëmurët me klirens të kreatininës më të vogël se 50 mL/min. duhet reduktuar doza e Ranitidina;
 - në pacientët me çrregullime të ritmit kardiak.

Shtatzënia

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë. Ranitidine nuk ka veprim të dëmshëm gjatë shtatzënisë. Gratë shtatzëna mund të trajtohen me Ranitidine.

Ushqimi me gji

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjen me qumësht gjiri. Ranitidine jashtëqitet me qumështin e gjirit, e si rrjedhim nënat duhet të kenë kujdes gjatë ushqyerjes me gji dhe gjithmonë duhet të veprojnë sipas këshillës së mjekut gjatë mjekimit

me këtë bar.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Ranitidine. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Ranitidine në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit sidomos këta të mëposhtmit:

- antiacidet dhe sukralfati (mund të ndërhyjnë në përthithjen e ranitidinës, prandaj ato duhet të merren 1 orë pas administrimit të saj);
- ketokonazol dhe itrakonazol (ul përthithjen e tyre e si pasojë duhet të merret 2 orë pas administrimit të këtyre barnave);
- enoksacinë (reduktion biodisponibilitetin oral);
- cefuroksimë dhe cefpodoksimë (reduktion përthithjen orale);
- delavirdinë (reduktion përthithjen);
- propanterlinë (kur administrohet njëkohësisht, reduktion përthithjen e ranitidinës);
- metforminë (reduktion klirensin);
- triazolam (mund të rritë përqëndrimin plazmatik të tij kur administrohen njëkohësisht).

Gjatë terapisë me Ranitidine bari mund të japë rezultat pozitiv të gabuar të testit proteinik të urinës Multistix.

3. SI TA MERRNI RANITIDINE

Gjithmonë merreni Ranitidine sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Ranitidine janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

- Për mjekimin e ulçerës gastrike beninje dhe duodenale përdoret një dozë e vetme 300 mg / ditë në darkë (nga goja) ose e ndarë në dy marrje me nga 150 mg në mëngjes dhe në darkë. Mjekimi zgjat të paktën 4 javë. Në ulçerën duodenale për të rritur shpejtësinë e mjekimit doza mund të dyfishohet dy herë në ditë nga 300 mg.
- Për mjekimin e ulçerës duodenale të shoqëruar me Helicobacter pylori përdoret një dozë 300 mg / ditë e kombinuar edhe me barna të tjerë amoksisilin 750 mg dhe metronidazol 500 mg, të dyja nga tre herë në ditë për dy javë. Terapia me ranitidinë duhet të vazhdohet edhe dy javë të tjera pas terapisë së kombinuar.
- Në gjendjet hipersekretore (p.sh. sindromi Zollinger-Ellison), trajtohen me 450 mg / ditë ndarë në tre marrje. Në raste të rënda përdoret në doza më të larta.

Fëmijët:

Përdoret për mjekimin e ulçerës peptike me dozë 2 - 4 mg / kg e dhënë 2 herë në ditë; doza maksimale 300 mg / ditë, doza mbajtëse 150 mg në darkë.

Në qoftë se keni marrë më shumë Ranitidine

Në qoftë se keni marrë më shumë Ranitidine se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Ranitidine

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj. Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a). Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjithë barnat e tjera, Ranitidine mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Njoftoni mjekun tuaj për efektet anësore të mëposhtme që mund t'ju shfaqen:

- ndër efektet mbi SNQ më të shpeshta janë: dhimbje koke, axhitim, konfuzion, delir, haluçinacion, paranoja, depresion dhe çorientim;
- çrregullime gastro-intestinale të lehta (diarre, konstipacion, nauze, të vjella, dhimbje abdominale);
- në raste të rralla mund të shkaktojnë: hepatit, ikter, rritje të transaminazave të mëlçisë, pankreatit;
- reaksiione mbindjeshmërie si: angioedema, bronkospazma, ethe, eozinofili;
- efekte anësore hematologjike ku bëjnë pjesë: neutropeni, granulocitopeni dhe trombocitopeni. Në raste të rralla mund të vërehen leukopeni, agranulocitozë, pancitopeni ose anemi aplastike;
- çrregullime të ritmit kardiak.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë

fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI RANITIDINE

Mbajeni larg fëmijëve. Mos e përdorni Ranitidine pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim. Mos e ruani mbi 25°C. Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Ranitadine

Lënda vepruese është ranitidinë klorhidrat. Çdo tabletë e veshur me film përmban ranitidinë klorhidrat ekuivalent me 150 mg ranitidinë bazë. **Përbërës të tjerë:** celulozë mikrokristalore, amidon i prexhelati-nizuar, stearat magnezi, dioksid silici koloidal, talk, kroskarmelozë natriumi dhe Opadry II i bardhë.




Përmbajtja e paketimit

Forma e paketimit: kuti me 20 tableta të veshura me film.

Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:

 Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

 Të mos përdoret tek fëmijët nën 12 vjeç.

 Përmbajtja.  Kujdes.  Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit për tregëtim dhe prodhuesi:

 **PROFARMA Sh.a.**
Rruga "Myslym Keta"
Tel./Fax: 00355 4 23 62 800
Tiranë - Albania

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Shtator 2013.

